


Manual përdorimi

Pajisja e karikimit të automjeteve elektrike IC-CPD

(**In-Cable Control- and Protection Device** -
Pajisje kontrolli dhe mbrojtjeje 'në kabllo')



Përmbajtja

Pajisja e karikimit të automjeteve elektrike IC-CPD

1. Informacion i përgjithshëm.....	2
2. Pasqyrë e pajisjes së karikimit IC-CPD ...	3
3. Paralajmërimet, simbolet dhe piktogramet e përdorura	4
4. Udhëzime sigurie.....	6
5. Karakteristikat kryesore	9
6. Përfitimet e përdoruesit dhe karakteristikat	10
7. Prizat e disponueshme të karikimit të automjetit dhe konektorët e automjetit...	11
8. Kabllot elektrike në dispozicion për prizat industriale	12
9. Kabllot elektrike në dispozicion për prizat shtëpiake	12
10. Ekranin e përparmë të kutisë së kontrollit ICCB	14
11. Përdorimi.....	15
12. Diagnostikimi	15
13. Rregullimi i defektit.....	15
14. Etiketa e pasme e kutisë së kontrollit ICCB	17

15. Mirëmbajtja dhe kujdesi.....	18
16. Modifikimet e produktit.....	18
17. Hedhja.....	19
18. Informacion për garancinë	19
19. Specifikimet.....	20
20. Shërbimi.....	21
21. Ndarës (opsional)	21

Shkurtesat

BEV.....	Automjet elektrik me bateri
PRCD-S.....	Çelës ndërprerës portativ
EVSE.....	Pajisje furnizimi e automjetit elektrik
FCC	Komisioni Federal i Komunikimeve
ICCB	Kutia e kontrollit 'në kablo'
IC-CPD.....	Pajisje kontrolli dhe mbrojtjeje
	'në kablo'
LED.....	Diodë ndriçuese (dritë treguese)
PHEV.....	Automjet elektrik hibrid me karikim

1. Informacion i përgjithshëm

Ky manual përdorimi bazohet në informacionet më të fundit të produktit në kohën e botimit. APTIV rezervon të drejtën për të modifikuar produktin pa njoftim paraprak. Të gjitha ndryshimet ose modifikimet e bëra te produkti mund të rezultojnë në humbje të garancisë nëse nuk bëhen nga një ofiçinë e autorizuar.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me përdorimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni përfaqësuesin tuaj të shërbimit. Për organizatën e shërbimit të klientit përgjegjëse për zonën tuaj, ju lutemi referojuni manualit të automjetit tuaj! 📧

Informacion për kompaninë


Aptiv Services Deutschland GmbH
Am Technologiepark 1
D-42119 Wuppertal
GJERMANI

Internet: www.aptiv.com

2. Pasqyrë e IC-CPD

Për përkufizimin e komponentëve individualë të sistemit referojuni pasqyrës më poshtë.

- A** Priza e karikimit të automjetit
- B** Konektori i automjetit (→ faqja 11)
- C** Kutia e kontrollit (ICCB)
- D** Kablloja elektrike AC
- E** Spina elektrike
- F** Priza e rrejtit
- G** Ekрани i përpasmë me LED (→ faqja 14)
- H** Etiketa e pasme (→ faqja 17)



3. Paralajmërimet, simbolet dhe piktogramet e përdorura

Paralajmërimet

RREZIK

Tregon një rrezik të menjëhershëm. Mosrespektimi i këtij udhëzimi shkakton **vdekje** ose **lëndim serioz**.

PARALAJMËRIM

Tregon një rrezik të afërt të mundshëm. Mosrespektimi i këtij udhëzimi mund të shkaktojë **vdekje** ose **lëndim serioz**.




KUJDES

Tregon një situatë të rrezikshme. Mosrespektimi i këtij udhëzimi mund të shkaktojë **lëndim të lehtë** ose **të vogël**.

SHËNIM

Tërheq vëmendjen për situatë që, nëse nuk shmanget, mund të shkaktojë dëme materiale.

Simbole

-  Referim në seksionet e tjera në Manualin e përdorimit
-  Referim në dokumente ose udhëzime të tjera
-  Udhëzim përdorimi

3. Paralajmërimet, simbolet dhe piktogramet e përdorura

Piktogramet



Udhëzim:
Ndiqni udhëzimet



Paralajmërim:
Tension elektrik



Paralajmërim:
Sipërfaqe e nxehtë



Paralajmërim:
Pengesë në tokë



Përdoreni me kujdes

Udhëzim: Përdoreni me kujdes pajisjen e karikimit



Ndalim: Mos përdorni përshtatës dhe priza të shumëfishta



Ndalim: Mos përdorni kablo zgjatuese



Ndalim: Mos e përdridhni kablлон



Ndalim: Mos e ekspozoni drejtpërdrejt në diell, mos e mbuloni drejtpërdrejt



Ndalim: Mos e zhytni në ujë, mos e ekspozoni ndaj ujit me presion ose mos e spërkatni me ujë



Ndalim: Nuk duhet të bjerë në kontakt me borën ose akullin



Ndalim: Mos e përdorni pajisjen e karikimit me kablo spirale



Ndalim: Mos shkelni mbi spinën, kutinë e kontrollit dhe kablлот




Ndalim: Mos e përdorni IC-CPD nëse është dëmtuar



Ndalim: Mos tentoni ta riparoni IC-CPD dhe mos e hapni atë



Ndalim: Mos e hiqni spinën nga priza elektrike gjatë procesit të karikimit



Diapazoni i temperaturës për ndezjen

4. Udhëzime sigurie

⚠ RREZIK

Shok elektrik ose rreziqe zjarri



Prizat e instaluara në mënyrë të parregullt mund të shkaktojnë shok elektrik ose zjarr gjatë karikimit të baterisë me tension të lartë përmes prizës së karikimit në automjet.

- Përdoreni pajisjen e karikimit IC-CPD vetëm në rrjet elektrik të tokëzuar siç duhet
- Priza që përdoret për karikim duhet të lidhet në qark të mbrojtur që është në përputhje me ligjet dhe standardet lokale
- Priza duhet të mbrohet me ndërprerës qarku elektrik (RCCB)
- Zbatoni udhëzimet e sigurisë në manualin e instalimit dhe në manualin e automjetit

⚠ RREZIK

Shok elektrik, qark i shkurtër, zjarr, shpërthim



Përdorimi i një kabloje defekteze ose të dëmtuar karikimi ose i një prize të dëmtuar ose defekteze, përdorimi i papërshtatshëm i pajisjes së karikimit IC-CPD ose mosndjekja e masave paraprake mund të shkaktojë qarqe të shkurtra, elektroskok, shpërthime, zjarr dhe djegie.

- Mos e përdorni pajisjen e karikimit IC-CPD nëse është e dëmtuar dhe/ose e ndotur. Kontrolloni kabllon dhe konektorin nëse është dëmtuar ose ndotur para se t'i përdorni ato



- Mos përdorni priza të konsumuara ose të dëmtuara. Spina elektrike duhet të vendoset mirë në prizë në përputhje me të gjitha kodet dhe rregulloret lokale

Përdorimi i pajisjes së karikimit IC-CPD të lidhur në një prizë të konsumuar ose të dëmtuar mund të shkaktojë lëndim serioz ose zjarr!

- Mos e hiqni kapakun dhe mos e hapni folenë. Pajisja nuk përmban pjesë që mund të riparohen ose zëvendësohen nga përdoruesi. Këtë detyrë lërbani stafit të kualifikuar (shih informacionin e shërbimit në ➔ faqen 21)
- Mos i prekni pjesët brenda konektorit të automjetit
- Mos përdorni mbitentension në pajisjen e karikimit IC-CPD! Për tensionet e prizës të përshtatshëm për pajisjen, ju lutemi referojuni specifikimeve në etiketën e pasme
- Mos përdorni kablo zgjatuese, tambur me kablo, priza të shumëfishta, përshtatës (udhëtimi), kohëmatës etj.



4. Udhëzime sigurie

- Mos bëni kurrfarë modifikimi ose riparimi të komponentëve elektrikë dhe mos e hapni pajisjen



- Mos i prekni kontaktet në prizën e karikimit në automjet dhe pajisjen e karikimit IC-CPD
- Mbajini prizat, lidhjen e spinave dhe pajisjen e karikimit IC-CPD larg lagështisë, ujit, borës, akullit dhe lëngjeve të tjera. Mos i zhytni kurrë në ujë



- Hiqni pajisjen e karikimit IC-CPD nga prizat gjatë stuhive
- Mos futni objekte në prizën e karikimit të automjetit ose në pajisjen e karikimit IC-CPD

- Pastrojeni pajisjen e karikimit IC-CPD vetëm nëse njësia e kontrollit është tërësisht e shkëputur nga rrjeti elektrik dhe nga automjeti. Përdorni pëlhurë të thatë për pastrim
- Pajisja e karikimit IC-CPD nuk duhet të përdoret nga personat nën ndikimin e drogës, alkoolit ose barnave
- Pajisja e karikimit IC-CPD nuk duhet të përdoret nga personat që nuk dinë ta përdorin ose që nuk e kanë lexuar manualin e përdorimit
- Mbajeni pajisjen e karikimit IC-CPD larg personave me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve që nuk mund ta vlerësojnë rrezikun nga përdorimi i saj
- Nuk duhet të kenë qasje në pajisjen e karikimit IC-CPD nga personat e paautorizuar (p.sh. fëmijët) gjatë kryerjes së procesit të karikimit pa mbikëqyrje

⚠ PARALAJMËRIM

Rrezik shpërthimi ose zjarri

Për ta kuptuar nëse automjeti është i pajisur me prizë karikimi, ju lutemi referojuni manualit të automjetit.

Komponentët e pajisjes së karikimit IC-CPD mund të shkaktojnë shkëndija dhe të ndezin avuj të ndezshëm ose shpërthyes.

- Gjatë karikimit sigurohuni që kutia e kontrollit të jetë e vendosur së paku 20 inç (50 cm) mbi tokë, që të reduktohet rreziku nga shpërthimi, veçanërisht në garazhe
- Mos e përdorni pajisjen e karikimit dhe kontrollin në mjedise ku ka potencial shpërthimi
- Kjo pajisje është e dedikuar vetëm për karikim të automjeteve, të cilat nuk kërkojnë ventilim gjatë procesit të karikimit

4. Udhëzime sigurie

SHËNIM

Pajisja e karikimit dhe kontrollit mund të dëmtohet

- Mos e vendosni pajisjen e karikimit IC-CPD në skaje të mprehta
- Mos e përdridhni kabllon e karikimit



- Mos shkelni mbi spinën, kutinë e kontrollit ose kabllot




- Mos ushtroni ndonjë tension mekanik të pazakontë mbi IC-CPD



Përdoreni me kujdes

- Mos e përdorni pajisjen e karikimit IC-CPD jashtë diapazonit të temperaturave të lejuara të ambientit

nga -22°F (-30°C) deri në 122°F ($+50^{\circ}\text{C}$). Temperaturat më të ulëta ose më të larta mund të dëmtojnë pajisjen



- Mos tentoni të lidhni konektorë dhe priza karikimi të automjetit që nuk përputhen
- Mos e përdorni pajisjen e karikimit IC-CPD me kablo spirale



Përdorimi i synuar

- Përdoreni kabllon e karikimit të lidhur drejtpërdrejt vetëm në prizë të fiksuara
- Ndalohet përdorimi i kabllot së karikimit për automjete nga prodhues të tjerë
- Përdorimi i gabuar mund të shkaktojë defekte dhe dëmtime të pronës. Pajisja e karikimit me pajisje të


integruar kontrolli dhe mbrojtjeje 'në kablo' (IC-CPD) nga APTIV-ja është një pajisje portative karikimi për automjete elektrike (EVSE) me lidhje elektrike për karikimin e automjeteve elektrike me bateri (BEV) dhe automjeteve elektrike hibride me karikim nga jashtë (PHEV)

Pajisja e sigurt, praktike dhe portative IC-CPD (modaliteti 2) u mundëson pronarëve të automjeteve elektrike t'i karikojnë automjetet e tyre kudo në rrjete rryme AC 100 V - 240 V, në varësi të rrjetit elektrik rajonal dhe versionit të pajisjes.

Ky sistem përbëhet nga tre komponentë të veçantë, të cilët së bashku ofrojnë një metodë solide dhe të sigurt karikimi të automjetit elektrik.


1. Kabllotja elektrike AC (lloji me prizë sipas rajonit) (➔ faqe 3 dhe 12)
2. Kutia e kontrollit ICCB (➔ faqe 3 dhe 13)
3. Lloji i konektorit të automjetit (sipas rajonit) (➔ faqe 3 dhe 11)

5. Karakteristikat kryesore

- Nivelet e sigurisë për përdoruesin, automjetin elektrik dhe pajisjen e karikimit IC-CPD
 - Monitorim i tokëzimit (në varësi të modelit)
 - Versioni juaj është pajisur me monitorim tokëzimi nëse është paraqitur ky simbol në etiketën e pasme
- 
- Versionet me monitorim tokëzimi nuk funksionojnë në rrjete elektrike pa përçues mbrojtës
 - Katër LED (përshkrim i hollësishëm i ekranit të përparmë, ➔ faqe 14)
 - Siguresë karikimi (PRCD-S) me rimbyllje automatike të qarkut
 - Çelës i kontrolluar me buton për lidhje të sigurt ndërmjet pajisjes së karikimit IC-CPD dhe konektorit të automjetit (vetëm për llojin 1 dhe GB/T, ➔ faqe 11)
 - Pajisja e karikimit IC-CPD shërben për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Për informacione më të hollësishme, ju lutemi referojuni etikës së pasme (➔ faqe 17)

6. Përfitimet e përdoruesit dhe karakteristikat

Kjo pajisje karikimi IC-CPD ju mundëson ta karikoni automjetin elektrik me bateri (BEV) ose automjetin elektrik hibrid me karikim nga jashtë (PHEV) pa ndonjë pajisje shtesë. Sistemi i spinës praktike bën që konektori i automjetit të përshtatet drejtpërdrejt në prizën e karikimit të automjetit dhe në infrastrukturën elektrike ekzistuese. Pajisja e karikimit IC-CPD siguron lidhje të tokëzuar elektrike standarde në prizat e ndërtesave rezidenciale nga 100 V deri në 240 V 50/60 Hz (në varësi të variantit të modelit) dhe rrymë karikimi nga 6 A deri në 16 A sipas specifikimeve në etiketën e pasme të kutisë së kontrollit të pajisjes suaj. 📄



Kabloja e automjetit:

- IEC 62196-1 Spina, priza, konektorë automjeti dhe priza automjeti – Karikimi konduktiv i automjeteve elektrike – Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme
- IEC 62196-2 Spina, priza, konektorë automjeti dhe priza automjeti – Karikimi konduktiv i automjeteve elektrike – Pjesa 2: Pajtueshmëria dimensionale dhe kërkesat e këmbyeshmërisë për kunjin AC dhe aksesoret e tubit të kontaktit
- Çelës afërsie me bazë mikroçelësi (ekskluzivisht për konektorë automjetit të llojit 1 dhe GB/T, ➔ faqe 11)

- Dorezë e ashpër për kontroll të lehtë bllokimi kundër rrëshqitjes (ekskluzivisht për konektorë automjeti të llojit 1 dhe GB/T, ➔ faqe 11)
- Mbajtëse ergonomike prej gome për mbështetje optimale
- Kur priza e karikimit të automjetit dhe priza elektrike lidhen saktë, të gjitha ndërfaqet e terminaleve dhe terminalet janë tërësisht të mbrojtura nga kontakti
- Monitorimi i temperaturës
 - IC-CPD monitoron vazhdimisht temperaturën brenda prizës elektrike, në mënyrë që të shmanget mbinxehja e prizës në kushte të caktuara

7. Prizat e disponueshme të karikimit të automjetit dhe konektorët e automjetit

Në varësi të pajisjes specifike sipas shtetit, ofrohen priza karikimi dhe konektorë të ndryshëm automjeti.





Përdorni vetëm pajisjen e karikimit të aprovuar për shtetin tuaj.

Priza e karikimit të automjetit

Konektori i automjetit



Lloji

Prizat e disponueshme të karikimit



IEC 62196-2
Lloji 2

- Dy mbështjellës kontakti 3 mm për kontroll të kontaktit
- Dy mbështjellës kontakti 6 mm për linjë
- Një mbështjellës kontakti 6 mm për kontakt tokëzimi



IEC 62196-2/SAE-J1772-2009
Lloji 1

- Dy mbështjellës kontakti 1,5 mm për kontroll të kontaktit
- Dy mbështjellës kontakti 3,6 mm për linjë
- Një mbështjellës kontakti 2,8 mm për kontakt tokëzimi



GB/T 20234.2
Lloji GB/T





- Dy kunjat kontakti 3 mm për kontroll të kontaktit
- Dy kunjat kontakti 6 mm për linjë
- Një mbështjellës kontakti 6 mm për kontakt tokëzimi

8. Kabllot elektrike në dispozicion për prizat industriale













Për karikim në shpejtësi optimale karikimi, përdorni vetëm prizat elektrike vijuese. Kapaciteti maksimal i karikimit është deri në 3,6 kW (në varësi të rrjetit elektrik/lidhjes elektrike të shtëpisë dhe karikuesit në bord).














➔ Merrni parasysh "Specifikimet" në faqen 20.

☑ Ndiqni udhëzimet në manualin e automjetit.

Priza	Konektori	Lloji
		IEC 60309-2 CEE 16/3 Lloji me fiksion
		JIS C 8303 (JWDS-0033)


9. Kabllot elektrike për prizat elektrike shtëpiake janë në dispozicion në versione të ndryshme të vendit

Priza	Konektori	Lloji
		NEMA-5-15 Lloji B
		CEE 7/7 Lloji E/Lloji F "Schuko"
		BS 1363 Lloji G
		AS 3112 Lloji I
		GB 2099.1 Lloji I
		SEV 1011 Lloji J

Priza	Konektori	Lloji
		AFSNIT 107-2 D1 Lloji K
		CEI 23-50 Lloji L
		SANS 164-1 Lloji M
		NBR 14136 Lloji N
		TIS 166-2549 Lloji O
		IRAM 2073 Lloji I
		CNS 690 Lloji B





ICCB:

- IEC 61851-1 Sistemi i karikimit konduktiv të automjeteve elektrike – Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme
- Monitorim i tokëzimit
 - Në varësi të pajisjes, ICCB mat rezistencën e përçuesit mbrojtës dhe ndërpret procesin e karikimit nëse vlera e matur është tepër e lartë
- Siguresë karikimi PRCD-S (pajisje mbrojtëse kundër shokut elektrik)
 - Dikton rryma problematike dhe çaktivizon procesin e karikimit
 - Një vetëtestim që shmang nevojën për kontroll mujor pas ndezjes dhe para çdo cikli të karikimit
- Siguresa e karikimit AKTIVE/ JOAKTIVE
 - Lejon vazhdimin e procesit të karikimit pas gabimeve të caktuara dhe pas një periudhe pritjeje prej 5 minutash
 - Nëse gabimi është korrigjuar, nuk kërkohet ndërhyrje nga përdoruesi
- Monitorimi i temperaturës
 - ICCB-ja monitoron vazhdimisht temperaturën brenda kutisë dhe rrjedhimisht parandalon mbinxehjen në kushte të caktuara




10. Ekran i përpamë i ICCB

Paneli i përpamë i IC-CPD është i pajisur me katër drita treguese:

- 
NDEZJE është ndezur:
Rryma nga rrjeti elektrik është aktivizuar dhe IC-CPD është gati për t'u përdorur
- 
KARIKIM pulson:
Drita pulsuese tregon se po përçohet energji në automjet
- 
TEMPERATURA është ndezur:
Temperatura e brendshme tejkalon një vlerë të caktuar
- 
DEFEKT pulson në të kuqe:
Tregon defekt në sistemin e karikimit

Sipas modalitetit të përdorimit, pajisja e karikimit IC-CPD lëshon kombinime të ndryshme të diodave ndriçuese dhe/ose pulsuese.

(Për shpjegim shtesë, shih ➔ faqen 17)



11. Përdorimi


Për përdorimin e pajisjes së karikimit IC-CPD, ndiqni udhëzimet vijuese:

1. Lexoni tërësisht dhe kuptoni manualin e automjetit dhe udhëzimet për pajisjen e karikimit IC-CPD




- Çmblihdni kablлон e pajisjes së karikimit IC-CPD




2.  Sigurohuni që kabllojt janë shtruar mirë në gjatësi, që të mos pengoheni

3. Futni spinën në prizë




4. Prisni derisa të ndriçojë vazhdimisht LED "Ndezje"




5. Futni konektorin e automjetit në prizën e karikimit të automjetit




6. Procesi i karikimit fillon automatikisht



7. Për ta ndërprerë procesin e karikimit, hapni prizën e karikimit të automjetit dhe hiqni konektorin e automjetit




8. Hiqni spinën nga priza



9. Mbajeni pajisjen e karikimit IC-CPD në një vend të sigurt

12. Diagnostikimi

1. Ekran: Dioda DEFEKT pulson tre herë dhe ndiqet me një pushim të shkurtër



2. Kontrolloni prizën ose mbrojeni pajisjen e karikimit IC-CPD nga drita e drejtpërdrejtë e diellit ose temperaturat e larta


13. Rregullimi i defektit

Veproni si më poshtë:

1. Hiqni konektorin e automjetit nga priza e karikimit të automjetit



2. Hiqni spinën nga priza




3. Prisni përafërsisht 5 sekonda



4. Futni spinën me kujdes në prizë



5. Prisni derisa të ndriçojë vazhdimisht LED "Ndezje"



6. Futni konektorin e automjetit në prizën e karikimit të automjetit



7. Procesi i karikimit rifillon automatikisht



SHËNIM



Nëse dioda DEFEKT vezullon vazhdimisht në të kuqe pas ose gjatë procesit të karikimit, mos e përdorni pajisjen; kontaktoni shërbimin tuaj rajonal të klientit (→ faqe 21).



14. Etiketa e pasme e ICCB

NDEZJE	KARIKIM	TEMPERATURA	DEFEKT	Piktogrami	Përshkrimi
					Nuk është diktuar furnizim me energji elektrike
					IC-CPD gati për t'u përdorur
					Karikim
					IC-CPD momentalisht është duke bërë vetëtestim
					Proces i ngadalësuar karikimi për shkak të temperaturës së rritur. Procesi i karikimit mund të zgjasë më gjatë
					Ndërprerje e karikimit për shkak të temperaturës së rritur të ICCB. Kontrolloni prizën ose mbrojeni pajisjen e karikimit IC-CPD nga drita e drejtpërdrejtë e diellit
					Ndërprerje e procesit të karikimit për shkak të temperaturës së rritur në spinë
					Defekt (→ faqe 16)
					Ka shkëputje të rrjetit elektrik ose rrjeti nuk mund të përdoret për karikim me këtë pajisje. Priza elektrike duhet të kontrollohet nga electricist i trajnuar

● = Ndezur

○ = Fikur

⊗ = Pulson

15. Mirëmbajtja dhe kujdesi

RREZIK

**Shok elektrik, qark i shkurtër,
zjarr, shpërthim**

Paralajmërim! Për të reduktuar rreziqet e shokut elektrik dhe të dëmtimit të pajisjes, pastroni spinat dhe folenë me kujdes të madh.



Pastrojeni pajisjen e karikimit IC-CPD me një leckë të thatë. Mos përdorni agjentë pastrimi ose tretës të ndezshëm, si alkool ose benzinë.



Ndalohet pastrimi ose kontakti me kimikate sepse mund ta dëmtojë pajisjen.

16. Ndryshimi i produktit

KUJDES!



Të gjitha ndryshimet ose modifikimet e produktit, të kryera jo nga një ofiçinë e autorizuar, shkaktojnë humbje të pajtueshmërisë me FCC dhe janë të ndaluara.

17. Hedhja



Hedhja e pajisjes së çmontuar duhet të bëhet në pajtim me ligjet e zbatueshme dhe udhëzimet rajonale dhe specifike sipas vendit.

Pajisjet dhe bateritë nuk duhet të hidhen kurrë me mbeturinat e shtëpisë.

- Pajisja e çmontuar duhet të vendoset në një fabrikë mbledhjeje të mbetjeve elektronike ose të hidhet përmes agjentit tuaj të shitjes
- Hidheni materialin e paketimit në koshin përkatës për karton, letër dhe plastikë

18. Informacion për garancinë

APTIV garanton që ky produkt nuk do të ketë mangësi në material dhe punim, si dhe në dizajn për periudhë prej një (1) viti nga data fillestare e blerjes. Nëse produkti ka mangësi në material, punim ose konstrukcion brenda periudhës së kësaj garancie, APTIV do ta marrë përsipër, në gjykimin e vet, riparimin ose zëvendësimin e produktit defektoz. Pjesët që riparohen dhe/ose produktet për zëvendësim

mund të zëvendësohen në gjykimin e APTIV ose me produkt të ri ose të riparuar. Garancia nuk përfshin riparimin e dëmtimit të shkaktuar nga instalimi i pasaktë, lidhja e parregullt e pajisjeve periferike, interferenca e jashtme elektrike, aksidenti, katastrofa, keqpërdorimi ose ndryshimet e bëra në produkt pa miratim me shkrim nga APTIV. Çdo shërbim riparimi që nuk mbulohet nga garancia e kufizuar do të bëhet sipas tarifave dhe kushteve të zbatueshme në momentin e riparimit.

Përfshihen të gjitha garancitë e tjera të shprehura ose të nënkuptuara në lidhje me këtë produkt, përfshirë garancinë e përshtatshmërisë së përgjithshme dhe përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar. Në disa shtete, përjashtimi i garancive të nënkuptuara nuk lejohet, kështu që mohimi i lartpërmendur i përgjegjësisë mund të mos vlejë në situatën tuaj.

Nëse produkti nuk është konform garancisë së lartpërmendur, kompensimi juaj ekskluziv do të jetë zëvendësimi ose riparimi i produktit me defekt, siç është përshkruar më lart. Në asnjë rrethanë APTIV, një përfaqësues shitjesh apo shërbimi ose kompania mëmë nuk mbajnë përgjegjësi ndaj klientit ose palës së tretë për çfarëdo dëmi që tejkalon çmimin e blerjes së produktit. Ky kufizim vlen për dëmet e çdo

lloji, përfshirë dëmet direkte ose indirekte, humbje të fitimit, humbje të kursimeve ose dëme të veçanta ose të rastësishme, dëme ndëshkuese dhe shkakësore, qoftë nga prishja ose shkelja e kontratës, ose lloj tjetër, ose nëse këto dëme bazohen në përdorimin ose përdorimin e pasaktë të produktit, edhe nëse APTIV ose një përfaqësues i autorizuar ose shitës i APTIV është këshilluar nga palë të treta për mundësinë e dëmeve të tilla ose ndonjë pretendim tjetër.

Në disa shtete, ndalohet përjashtimi i dëmeve të rastësishme ose shkakësore për disa produkte, kështu për ju mund të mos vlejë kufizimi ose përjashtimi i lartpërmendur.

Kjo garanci ju jep të drejta specifike ligjore dhe mund të gëzoni edhe të drejta tjera, të cilat ndryshojnë nga një shtet në tjetrin.

Ju lutemi kontaktoni stafin e shërbimit të klientit. Për shërbimin përgjegjës të klientit, ju lutemi referojuni manualit të automjetit tuaj! 📄

19. Specifikimet

Specifikimet elektrike

Energjia:	maks. 3,6 kW (në varësi të modelit dhe versionit)
Rryma nominale:	maks. 16 A (në varësi të variantit të modelit)
Tensioni nominal:	1-fazor: 100 - 240 V ~ (në varësi të variantit të modelit)
Frekuenca e rrjetit:	50 Hz - 60 Hz
Kategoria e mbitensionit:	II
Rryma nominale e qëndrueshmërisë afatshkurtër:	< 10 kA rms
Siguresa e rrymës së mbetur:	Lloji A
Klasa e mbrojtjes:	II
Klasa IP e mbrojtjes:	IP67 (ICCB)
Variantet e spinës:	Faqja 12 Spinat e disponueshme për priza industriale Spinat e disponueshme për priza shtëpiake
Variantet e prizës së karikimit të automjetit dhe konektorëve të automjetit:	Faqja 11 Prizat e disponueshme të karikimit të automjetit dhe konektorët e automjetit

Dimensionet dhe pesha

Dimensionet e karikuesit IC-CPD: Afro 3,74 inç x 8,66 inç. x 2,32 inç. (95 mm x 220 mm x 59 mm) (gjer. x lart. x thell.)

Pesha e karikuesit IC-CPD: Afro 5,18 lbs. (2,35 kg)

Kushtet e mjedisit

Temperatura e përdorimit: -22°F deri +122°F (-30°C deri +50°C)

Temperatura e ruajtjes: -40°F deri +158°F (-40°C deri +70°C)

Lagështia: Deri 95%, jokondensuese

Lartësia: maks.16 404 ft (5000 m)
mbi nivelin e detit

Udhëzimet dhe standardet


Direktivat e Bashkimit Evropian:

- 2014/35/BE, 2014/30/BE
- 2011/65/BE

Standardet: Kjo pajisje karikimi IC-CPD i plotëson të gjitha standardet IEC dhe EN dhe rregulloret e zbatueshme në kontekstin e legjislacionit kombëtar, si dhe rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare. Nëse është e nevojshme, mund të vihet në dispozicion deklarata përkatëse e përputhshmërisë

20. Shërbimi

Ju lutemi kontaktoni shitësin tuaj lokal për asistencë.

Për informacion kontakti, ju lutemi referojuni manualit të automjetit tuaj! 



21. Ndarës opsional (në varësi të modelit)

Hiqni ndarësin kur nuk ju nevojitet:

